

A K T T H E M E L I M I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALBKONF"



Ne Tirane, sot me __.02.2001, ne, te nenshkruarit 1. Alban Qazimi, lindur ne Tirane, me 25.01.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga "Kongresi i Lushnjes", Pall.39, Ap.15 Tirane, dhe 2. Lytfi Berberi, lindur me 28.07.1963, ne Tirane dhe banues ne Tirane, Rruga "Myslym Shyri", pall. 46/1, Ap.12, duke gezuar te gjithë zotesin per te vepruar, me vullnet te lire vendosem te hartojme e nenshkruajme kete akt themelimi per krijim shoqerie tregetare me pergjegjesi te kufizuar me kushtet e parashtruara me poshte :

1. Me cilesin e Ortakeve themelues krijojme shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar, e cila do te regjistrohet si person juridik dhe do te ushtroje veprimtari private ekonomike, prodhuese, tregtare e financiare ne baze te ketij Akti Themelimi, te Statutit te shoqerise (qe i bashkelidhet kesaj kontrate) dhe ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

2. Shoqeria do te emertohet : Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar "Albkonf" ose shkurt "Albkonf" shpk.

3. Selia (qendra administrative) e shoqerise eshte ne adresen : Rruga "Ndre Mjeda", Godina Ish-reparti i oreve - Uzina metalike "Tirana", Tirane, Shqiperi.

Selia mund te ndryshohet ne varesi me shtrirjen dhe zgjerimin e aktivitetit te shoqerise si dhe mund te hapen, filiale te saj edhe ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise.

4. Shoqeria krijohet me nje afat kohezgjatje deri ne 20 (njezet) vjete.

5. Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Krijimi i modeleve, perpunimi dhe tregtimi per vete dhe per llogari te te treteve te konfeksioneve ne pergjithesi, per burra e gra, prodhuar nga tekstile te çdo lloji.

- Importimi dhe eksportimi ne vazhdimesi te teksilit dhe konfeksioneve te llojeve te ndryshme pjeserisht ose teresisht i punuar dhe tregtimi i tyre me shumice ose me pakice.

Importimi dhe eksportimi; ne forme te perkoheshme dhe/ose definitive te mjeteve dhe te makinerive, lendeve te para dhe materialeve ndihmese dhe gjithshkaje tjeter te nevojshme per realizimin e proceseve prodhuese a perpunuese si dhe te drejtimit manaxherial.

- Blerja ose marrja me qera, me emfiteoze ose ne cdo menyre tjeter te lejuar nga legjislacioni shqiptar te ndertesave ashtu si edhe te te mirave te luajtshme dhe te paluajtshme pjese e tyre te dobishme per realizimin e proceseve te prodhimit apo tregtimit.
- Per arritjen e qellimeve te saja, shoqeria mund te marre pjese ne forme direkte ose/dhe indirekte, ne sipermarrje te tjera ose shoqeri vendase ose te huaja, ne operacione te ndryshme tregtare e financiare, qe kane perputhje me kete objekt te shoqerise.

Objekti i shoqerise, me rritjen e aktivitetit te saj mund te zgjerohet me tej, kurdohere ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

6. Kapitali themeltar fillestar i shoqerise ka vleren 100.000 (njqindemije) leke.

Kapitali i shoqerise mund te rritet ose pakesohet me vendim te Ortakeve.

7. Kapitali themeltar ndahet ne 100 (njqinde) kuota me vlere nominale 1000 (njemije) lek seicila.

Ortaket bien dakort qe z.Alban Qazimi te kontribuoj ne shoqeri me vleren 90.000 lek ndersa z.Lytfi Berberi ne vleren 10.000 lek.

Sipas ketij kontributi kuotat e shoqerise do te ndahen :

Ortaku z.Alban Qazimi gezon ne shoqerine "Albkonf" shpk 90 (nentedhjete) kuota (pjese) ose 90% te vleres se pergjithshme, ndersa ortaku tjeter z. Lytfi Berberi gezon ne kete shoqeri 10 (dhjete) kuota (pjese) ose 10% te vleres se pergjithshme.

8. Shoqeria "Albkonf" Shpk eshte pronare dhe perdoruese e kapitalit (pasurise) se saj.

Shoqeria gezon te drejtat dhe merr persiper detyrime sikunder çdo person juridik tjeter ne Shqiperi ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

9. Fitimet qe realizohen nga shoqeria e qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, jane perfitim i drejteperdrejt i ortakeve te shoqerise si zoterues te kapitalit ne formimin e shoqerise, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore dhe kreditoret e ndryshem.

10. Ne rastin kur nje nga ortaket deshiron te transferoje tek te tretet kuotat e shoqerise do te zbatohen parashikimet e statutit te shoqerise dhe dispozitat perkatese te legjislacionit ne fuqi.

11. Shoqeria "Albkonf" Shpk vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit qe kane derdhur per te.

12. Shoqeria do te kete vulen dhe timbren e saj me formen, inicialet dhe permbajtjen qe percaktohet ne statut.

13. Shoqeria do te çele llogari rrjedhese e likujduese ne banke.

14. Organizimi, drejtimi, administrimi e problemet e tjera qe lidhen me funksionimin normal te shoqerise, percaktohen me hollesi ne statutin e saj.

15. Organi me i larte drejtues, kontrollues e vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve te shoqerise.

16. Ortaket caktojne Administratorin e Pergjithshem te shoqerise dhe nese e gjykojne te nevojshme per mbarevajtjen e shoqerise mund te caktojne edhe disa persona te trete me cilesin e administratoreve te shoqerise duke percaktuar per ta edhe funksionet e fuqite perkatese qe duhet te gezojne ne administrimin e shoqerise. Keto do te gjejne pasqyrim ne aktet e shoqerise dhe ne statutin e saj.

17. Administratoret si dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar te zbatojne me rigorozitet ligjet ne fuqi, kushtet e ketij akti themelues e te statutit te shoqerise si dhe te ruajne sekretin per veprimet ekonomike, tregtare e financiare te shoqerise.

18. Per maredheniet e ndersjellta ne te ardhmen ndermjet ortakeve dhe administratoreve e punonjesve te tjere te shoqerise si dhe midis tyre e personave te trete do te zbatohen parashikimet e statutit te shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

19. Veprimet kontabile per perlllogaritjen e aktivitetit ekonomik e financiar te shoqerise do te mbyllen ne 31 dhjetor te çdo viti duke nxjerre bilancin ekonomik Fitim - Humbje.

Per bilancin kontabel dhe menyren e vleresimit te tij vendos mbledhja e ortakeve te shoqerise.

20. Shperndarja e shoqerise ose pushimi (likujdimi) i veprimtarise se saj para afatit si dhe transferimi i saj ne nje lloj shoqerie tjetere, mund te behet vetem duke u respektuar rregullat e percaktuara ne statutin e shoqerise dhe dispozitat perkatese ligjore ne fuqi.

21. Vendimin per likujdimin e shoqerise mund ta marrin vetem ortaket e shoqerise duke respektuar e zbatuar ne çdo rast dispozitat ligjore ne fuqi per kryerjen e ketij procesi.

22. Mosmareveshjet qe mund te lindin ne maredheniet e brendeshme te shoqerise dhe ndermjet saj e personave te trete fizik ose juridik duhet te zgjidhen me mirekuptim dhe kur nuk arrihet nje gje e tille atehere do te zgjidhen nga organet kompetente gjyqesore ose te arbitrazhit te Republikes se Shqiperise.

23. Per problemet qe nuk jane parashikuar shprehimisht ne kete akt themelues ortaket e shoqerise dhe çdo person tjetere i interesuar detyrohen t'u referohen statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi e ne menyre te veçante Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

24. Statuti i shoqerise i miratuar dhe i nenshkruar rregullisht nga Ortaket konsiderohet pjese perberese e akteve baze te formimit dhe rregullimit te aktivitetit te shoqerise dhe eshte i detyrueshem per




zbatim nga ortaket si dhe çdo person tjetër që mund të veprojë në kuadrin e aktivitetit të kësaj shoqërie dhe për interesa të saj.

25. Ky Akt-Themelimi fiton fuqi vepruese menjëherë pas marrjes së vendimit për njohjen e shoqërisë si person juridik nga Gjykata e rrethit të Tiranës dhe regjistrimit në regjistrin tregëtar të shoqërive tregëtare pranë kësaj gjykate.

26. Ky akt u hartua në 4 kopje të njëjta, në gjuhën shqipe dhe duke qenë se gjendet në pajtim me vullnetin tonë të lirë si ortak themelues nënshkruhet rregullisht prej nesh, sot me datë ___/02/2001, në Tiranë.

O r t a k e t t h e m e l u e s

Alban QAZIMI dhe Lytfi BERBERI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISE.
DHOMA E NOTEREVE TIRANË


Nr. 265 Rep.

Nr. - Kol.

V E R T E T I M

Në Tiranë, sot me datë 22, 02, 2001, përpara meje u paraqitën personalisht z. Alban Qazimi, lindur në Tiranë, me 25.01.1972 banues në Tiranë, dhe z. Lytfi Berberi, lindur në Tiranë, me 28.07.1963 dhe banues në Tiranë, të njohur personalisht prej meje, të cilët nënshkruan në praninë time aktin e themelimit të shoqërisë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar "ALBKONF" shpk, akt i përpiluar jashtë kësaj zyre duke deklaruar se përmbajtja e tij shpreh vullnetin e tyre të lirë.

Kete fakt real une noterja e vertetoj rregullisht me nënshkrimin tim.





STATUT

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " ALBKONF" SHPK.

Neni 1 Forma

Shoqeria "ALBKONF " eshte person juridik shqiptar, Shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar me akt-themelimi nga ana e Z. Alban Qazimi, lindur ne Tirane, me 25.01.2972 dhe banues ne Tirane,dhe Z.Lytfi Berberi, lindur ne Tirane, me 28.07.1963 dhe banues ne Tirane, Shqiperi me qellimin per te ushtruar veprimtari ekonomike me qellim fitimi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 2. Emertimi

Shoqeria emertohet : Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, "ALBKONF" ose shkurt "ALBKONF" Shpk.

Neni 3. Selia. Qendra administrative

Shoqeria e ka seline e saj ne Rr"Ndre Mjeda", Godina - Ish reparti i oreve-Uzina Metalike "Tirana", Tirane Shqiperi.

Selia e shoqerise mund te ndryshohet ne varesi te shtrirjes dhe zgjerimit te veprimtarise se saj.

Shoqeria mund te krijojte perfaqesi (filiale) ose Agjensi te tjera ne territorin e Republikes se Shqiperise e jashte saj, me miratimin e organeve kompetente dhe sipas legjislacionit te vendit ku krijohen.

Neni 4. Kohezgjatja.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte deri ne 20 (njezet) vjet.

Kjo veprimtari fillon nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane.

Shperndarja ose pushimi i parakohshem (para afatit) i veprimtarise se shoqerise mund te behet vetem ne kushtet e percaktuara ne kete statut.



Neni 5 Objekti.

Objekti aktual i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Krijimi i modeleve, perpunimi dhe tregtimi per vete dhe per llogari te te treteve te konfeksioneve ne pergjithesi, per burra e gra, prodhuar nga tekstile te çdo lloji.
- Importimi dhe eksportimi ne vazhdimesi te teksitilit dhe konfeksioneve te llojeve te ndryshme pjeserisht ose teresisht i punuar dhe tregtimi i tyre me shumice ose me pakice.
- Importimi dhe eksportimi; ne forme te perkoheshme dhe/ose definitive te mjeteve dhe te makinerive, lendeve te para dhe materialeve ndihmese dhe gjithshkaje tjeter te nevojshme per realizimin e proceseve prodhuese a perpunuese si dhe te drejtimit manaxherial.
- Blerja ose marrja me qera, me emfiteoze ose ne cdo menyre tjeter te lejuar nga legjislacioni shqiptar te ndertesave ashtu si edhe te te mirave te luajtshme dhe te paluajtshme pjese e tyre te dobishme per realizimin e proceseve te prodhimit apo tregtimit.
- Per arritjen e qellimeve te saja, shoqeria mund te marre pjese ne forme direkte ose/dhe indirekte, ne sipermarrje te tjera ose shoqeri vendase ose te huaja, ne operatione te ndryshme tregtare e financiare, qe kane perputhje me kete objekt te shoqerise.

Neni 6. Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njqindemije) leke.

Kapitali i shoqerise mund te rritet ose pakesohet me vendim te Ortakeve.

Neni 7
KUOTAT (Pjeset) e kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise ndahet ne 100 kuota (pjesë) me vlerë nominale 1000 lek seicila.

Ortakët bien dakort që z. Alban Qazimi të kontribuoj në shoqeri me vlerën 90.000 lek ndërsa z. Lytifi Berberi në vlerën 10.000 lek.

Sipas këtij kontributi kuotat e shoqerise do të ndahen :

Ortaku z. Alban Qazimi gëzon në shoqerine "Albkonf" shpk 90 (nëntëdhjetë) kuota (pjesë) ose 90% të vlerës së përgjithshme, ndërsa ortakët tjetër z. Lytifi Berberi gëzon në këtë shoqeri 10 (dhjetë) kuota (pjesë) ose 10% të vlerës së përgjithshme.

Neni 8.
Transferimi i kuotave

Pjesët e kapitalit themeltar të shoqerise me vendim të ortakëve të shoqerise mund të transferohen pjesërisht ose tërësisht tek të tjerët. Ato janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt noterial.

Neni 9.
Lenia peng e kuotave.

Shoqeria ka të drejtë që të lere peng pjesët e kapitalit themeltar të saj.

Neni 10.
Fitimi.

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë së shoqerise, konkretizohen me rastin e nxjerrjes së bilanceve periodike, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore dhe kreditoret e ndryshëm. Fitimi do të ndahet sipas kuotave të kapitalit themeltar.

Neni 11.
Fondi rezerve.

Ne çdo rast, nga fitimi i realizuar veçohet si fond rezerve i shoqerise jo me pak se 5 % e tij, shume e cila mbahet si rezerve e shoqerise. Masa e ketij fondi mund te shtohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Neni 12 Disponimi i kapitalit.

Shoqeria "ALBKONF" Shpk eshte pronare perdoruese dhe disponuese e pasurise se vet, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise se kryer.

Ajo mund te bleje e te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per t'u ofruar pasurine e saj personave te trete per garanci per te marre kredi bankare.

Neni 13 Pergjegjesia materiale e financiare.

Shoqeria "ALBKONF" Shpk vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket e mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E TYRE.

Neni 14

Autoriteti me i larte drejtues, kontrollues e vendimor per shoqerine "ALBKONF" Shpk eshte Asambleja e ortakeve. Mbledhja e saj mund te thirret nga Administratori i Pergjithshem, Eksperti kontabel i autorizuar ose likujduesi, ose nga shumica e ortakeve.

Neni 15

Vendimet dhe urdherat e Asamblese se ortakeve te shoqerise jane te detyrueshme per administratoret dhe punonjesit e tjere te shoqerise.

Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.

Asambleja e zakonshme vendos per ceshtje te tilla si emerim ose shkarkim te administratorit te pergjithshem, te ekspertit kontabel te autorizuar dhe likujduesit, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, te ndarjes se fitimit etj.

Asambleja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si : ndryshimi i statutit, zvogelimin ose zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar, shnderrimin e shoqerise nga forma e sh.p.k. ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe etj.

Neni 16 Administrimi i shoqerise.

Shoqeria "ALBKONF" Shpk administrohet nga Administratori i Pergjithshem i saj. Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej 3 vjetesh, me te drejte riemerimi, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit para afatit.

Kete pozite aktualisht e gezon z.Alban Qazimi.

Ortaket mund te vendosin ne çdo kohe, duke marre paraprakisht edhe mendimin e Administratorit te Pergjithshem caktimin ne detyren e administratorit te shoqerise nje ose disa persona te tjere duke percaktuar edhe rrethin e te drejtave e kompetencave te tyre te pergjithshme dhe te veçanta.

Neni 17 Kompetencat e Administratorit te Pergjithshem.

Administratorit i Pergjithshem i shoqerise eshte personi i vetem qe gezon te drejten e firmes mbi aktet e shoqerise si dhe ne dokumentat e tjera te shoqerise ne lidhje me zbatimin e Vendimeve te Asamblese se Ortakeve.

Administratori i Pergjithshem ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre kopetencave qe jane te Asamblese se Ortakeve.

Administratori i Pergjithshem eshte pergjegjes ndaj shoqerise apo te treteve per shkeljet e ligjeve te Statutit te shoqerise , te kryera me faj prej tij gjate administrimit te shoqerise.

Neni 18
Perfaqesimi.

Administratori i Pergjithshem i saj eshte personi qe perfaqeson shoqerin ne maredheniet me persona te trete fizik e juridik.

Kopetencat e Administratorit te Pergjithshem jane :

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te kryeje propozimet e nevojshme ne Mbledhjet e Asamblese , kur lind nevoja e ndryshimit te kapitalit themeltar..
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise , duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen Asamblese per krijimin e njesive (filialeve) , agjensive, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit .
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ja paraqese ate Asamblese per miratim.
- Te perzgjedhe ekspertet kontabel te autorizuar dhe anetaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqese propozimet per miratim ne Asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te Asamblese se Ortakeve.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

Neni 19
Delegimi i kompetencave.

Ortaket jane te lire ti delegojne kompetencat e tyre personave te trete qe ai gjykon te aresyeshme, por gjithmone duke respektuar dispozitat e ketij satuti dhe legjislacionit ne fuqi.

Neni 20
Vula

Shoqeria ka vulen dhe timbren e saj me mbishkrimin : "Shoqeria
"ALBKONF" shpk - Tirane - Republika e Shqiperise".

NO 14
TIRANE

Neni 21
Llogaria bankare.

Shoqeria ka te hapur llogari rrjedhese e likujduese ne Banke. Nepermjet bankes ajo kryen veprimet e nevojshme ekonomiko-financiare me partneret e trete vendes apo te huaj, duke likujduar me monedhe shqiptare ose te huaj (sipas mareveshjeve te perfunduara) dhe duke respektuar ne çdo rast dispozitat ne fuqi.

Neni 22
Vlera e dokumentave te shoqerise.

Aktet, kontratat, faturat, njoftimet e dokumentat e tjera te shoqerise jane te vlefshme dhe ushtrojne pasoje ligjore vetem kur jane nenshkruar rregullisht nga Administratori i Pergjithshem i saj (apo edhe nga personi i autorizuar me shkrim prej tij) dhe kur permbajne vulen e shoqerise.

Dokumentat qe rregullojne marredheniet me bankat ose me organet e tjera te sistemit financiar nenshkruhen nga Administratori i Pergjithshem, si firme e pare dhe ne mungese te tij nga nje person tjetër, por kurdohere i pajisur me prokure me shkrim.

Neni 23.
Bilancet dhe kontroll revizioni.

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen ne çdo fund viti financiar, me 31 dhjetor

Ne fund te çdo periudhe veprimtarie personat e ngarkuar nxjerrin bilancin kontabel me rezultatin ekonomik fitim-humbje, i cili shqyrtohet nga Administratori i shoqerise jo me vone se 2 (dy) muaj nga dita e nxjerrjes, dhe me pas i kalon per miratim Asamblese se Ortakeve.

Per te kontrolluar e siguruar nje veprimtari ekonomike efektive te shoqerise, Administratori ka te drejte te urdheroj berjen e kontroll revizionit mbi kete veprimtari ne çdo kohe e per çdo rast qe ai e gjykon te nevojshme. Kontrolli i shoqerise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me te drejte riemerimi. Emerimi dhe shkarkimi i tij behen nga Asamblea e Ortakeve.

Neni 24.

Shperndarja e shoqerise ose pushimi i veprimtarise se saj para afatit.

Shoqeria mund te shperndahet ne keto raste :

a. Kur humbjet ne bilanc ose ne aktivitetin e saj e reduktojne kapitalin e shoqerise ne nje vlere me te vogel se gjysma e kapitalit themeltar te saj.

b. Kur vendoset me vendim te shprehur te ortakeve.

c. Kur, sipas procedures se pikes "b" vendoset shnderrimi i shoqerise ne nje shoqeri te llojit tjetër.

Ne rastet e shperndarjes se shoqerise me vendim te Asamblese se Ortakeveper çdo aresye qofte Administratori i shoqerise merr masat e nevojshme per mbylljen e aktivitetit, per llogaritjen e te ardhurave dhe shpenzimeve, per shlyerjen e detyrimeve te sa ndaj te treteve duke propozuar komisionin e likujdimit. Komisioni paraqet bilancin e likujdimit, i cili miratohet nga Asamblea.

Gjithashtu, ne kete rast behet edhe likujdimi i administratoreve dhe i punonjesve te tjere te shoqerise ne masen qe ju takon.

Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te Bilancit te likujdimit.

Neni 25

Detyrime te tjera.

Administratoret dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar :

a. Te zbatojne me rigorozitet legjislacionin ne fuqi, kushtet e ketij statuti dhe te kontrates se shoqerise gjate ushtrimit te detyrave te tyre.

b. Te ruajne sekretin per veprimet ekonomiko-finaciare.

NOTE
TIRANË

Neni 26
Punesimi.

Shoqeria per nevojat e veprimtarise se saj, puneson punetore e nenpunes, vendas dhe te huaj duke respektuar te gjitha ligjet dhe rregullat ne fuqi per punesimin ne Republiken e Shqiperise.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese, duke derdhur rregullisht kontributet sipas dispozitave ligjore.

Neni 27.
Mosmarevshjet.

Ne rast se gjate aktivitetit te shoqerise lindin mosmarevshje midis Ortakeve me pjesetare te tjere te shoqerise (administratore, punonjes etj) si dhe me persona te trete fizik e juridik keto duhet te zgjidhen me mirekuptim (konsensus) dhe ne rast te kundert, do te zgjidhen nga organet gjyqesore kompetente te parashikuara ne legjislacionin shqiptar.

Neni 28.
Dispozita te fundit.

Te gjitha veprimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante, i cili mbahet ne seline e shoqerise.

Per ceshtjet apo problemet qe nuk kane gjetur zgjidhje ne kete statut, zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi dhe, ne menyre te vecante Ligji Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregetare".

Neni 29.

Statuti i shoqerise se perbashket "ALBKONF" Shpk perpilohet ne 4 (kater) kopje, te njejta, ne gjuhen shqipe.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"ALBKONF" Shpk

/ ALBAN QAZIMI /



/ LYTFI BERBERI /



Republika e Shqiperise

Dhoma e notereve Tirane.

Nr. 266 Rep.

Nr. - Kol.



VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 22, 02, 2001, perpara meje u paraqiten personalisht z.Alban Qazimi, lindur ne Tirane, me 25.01.1972 banues ne Tirane, dhe z. Lytft Berberi, lindur ne Tirane, me 28.07.1963 dhe banues ne Tirane, te njohur personalisht prej meje, te cilet nenshkruan ne pranin time statutin e shoqerise tregtare "ALBKONF" shpk, akt i perpiluar jashte kesaj zyre dhe deklaroj se permbajtja e saj shpreh vullnetin e tyre te lire.

Kete fakt real une noterja e vertetoj rregullisht me nenshkrimin tim.

NOTERE

